



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
KËSHILLI DREJTUES

VENDIM

Nr. 15, datë 23.05.2025

PËR
CAKTIMIN E GRANT THORNTON SH.P.K.
SI AUDITUES I BRENDSHËM I SPECIALIZUAR,
PËR AUDITIMIN E BRENDSHËM TË
AGJENCISË SË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE PËR PERIUdhËN 2025 - 2028

Në bazë dhe për zbatim të nenit 44, pika 2, të nenit 52, pika 1, shkronja “j”, të nenit 63, pika 2 të ligjit nr. 53/2014 “Për sigurimin e depozitave” i ndryshuar, të nenit 10, pika 1, shkronja “ç” të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar, të nenit 18 të Statutit të Agjencisë të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 24, datë 31.10.2018, të nenit 5 të Rregullores të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 16, datë 30.04.2020 “Për Kartën e Auditimit të brendshëm në Agjencinë e Sigurimit të Depozitave”, të ndryshuar, të nenit 18 të Rregullores të miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 03.11.2014 “Për rregullat dhe procedurat e funksionimit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave”, me propozim të Drejtorit të Përgjithshëm, Këshilli Drejtues,

V E N D O S I:

1. Të caktojë Grant Thornton sh.p.k., si auditues i brendshëm i specializuar, për auditimin e brendshëm të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, për periudhën 2025.
2. Të autorizojë Drejtorin e Përgjithshëm për nënshkrimin e kontratës me Grant Thornton sh.p.k për vitin 2025, me të drejtë rinovimi një vjeçar për auditimin e viteve 2026, 2027 dhe 2028.





3. Ngarkohet Sektori i Marrëdhënieve me Publikun për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

Shqipe Malaj

Donald Duraj

Sekretare

Kryetar

